REVISTA KULTURA ISLAME TRYEZË E MENDIMIT ISLAM

Rexhep Suma
Faculty of Islamic Sciences Prishtina, Kosovo

HYRJA

Me anë të këtij punimi shkencor, kam prezantuar rolin dhe peshën historike që ka luajtur periodiku islamë në përgjithësi e revista "Kultura Islame", në veçanti atë kohë trazirash, furtunash e vlimesh politike që karakterizohej gadishulli ballkanik. Ky punim shkencor bashkëkohor mbetet e lidhur shumë ngushtë me kahet e zhvillimeve të sotme të kombit tonë dhe të kulturës islame e shqiptare, ndaj, si e tillë, është një arsye shtesë e përzgjedhjes së saj. Qëllimi kryesor është njohja objektive e rolit që kanë luajtur shtypi dhe periodiku fetar në aspektin e formimit të drejtë islam, kulturor, arsimor, shoqëror e kombëtar të shqiptarëve në gadishullin ballkanik.

Duke hulumtuar numrat e kësaj reviste hasim artikuj ku çmohen e vlerësohen harmonia, toleranca, bashkëjetesa fetare dhe atdhedashuria që e karakterizonin popullin shqiptar, por që njëkohësisht përkthehet edhe si nxitje për t'i ruajtur këto veçanti identitare unikate të kombit tonë.

Revista "Kultura Islame", ofroi një gamë të gjerë artikuj shkencor nga bota filozofike, letrare, morale dhe shoqërore si organ zyrtar i Komunitetit Mysliman Shqiptar, që udhëhiqej nga drejtuesi i saj z.Sadik Bega. Kjo revistë pa dritën e botimit vetëm 5 vite, nga 1 shtatori1939, dhe që vazhdoi deri në fillim vitin e1946. Faqet e kësaj reviste përbëjnë një etos të trashëgimisë tepër të vlefshëm

në lëmin e historisë së letërsisë islame në të gjuhës së ëmbël shqipe. Temat që i trajtoi në atë botë, ushqenin trurin e inteligjencës shqiptare dhe jo vetëm duke paraqitur një gamë të artikujve nga natyra e mendimit filozofik, letrar, historike dhe fetar, porse objektivi qendror i saj ishte ofrimin e frymës dhe zërit të "Kulturës Islame" dhe mendimit.

Ky artikull s'do mend se pasqyron historikun e shtypit fetar në hapësirat shqipfolëse. Po ashtu ky artikull dhe tjetër në konferencën që është mbajtur plotëson dhe një mungesë të konsiderueshme, por njëherazi edhe i hap rrugë thellimit dhe studimeve të mëtejme të kësaj sfere, që mbi të gjitha pasuron dhe paraqet prurje të reja në fushën e periodikut fetar islam ndër shqiptarë.

REVISTA "KULTURA ISLAME" DHE ROLI I SAJ NË DREJT INFORMIMIN ISLAM

Revista "Kultura Islame", botim filozofik, letrar, moral e shoqëror i Komunitetit Musliman Shqiptar me drejtor përgjegjës z. Sadik Bega, mbuloi një hapësirë kohore nga 1 shtatori i vitit 1939, deri më janar-shkurt të vitit 1946. Revista paraqet një trashëgimi të paçmuar të historisë së letrave islame në gjuhën shqipe. Ajo doli nga arkivat, për të arritur më lehtësisht në publik, për të dhënë kështu jo vetëm një grafik të mendjes dhe mjedisit shqiptar të disa dekadave më parë, por edhe për të ofruar një cikël të freskët shkrimesh filozofike, letrare, historike e fetare. Që në numrin e saj të parë politika redaksionale ishte tejet e qartë në objektivat që kishte para vetës duke konfirmuar faktin se në fokus do të jetë përfaqësimi me shpirtin e vërtetë të kulturës dhe mendimit islam.

Mediet me përmbajtje fetare në gjuhën shqipe vazhdojnë të mbesin një kujtesë kolektive dhe ishin një element rezistence të gjallë karshi okupimit sllav dhe pasqyronin me pendë të bëmat e okupatorit. Këto medie kanë dhënë një kontribut tejet të çmuar dhe të rëndësishëm në ruajtjen dhe promovimit të dialogut ndërfetar që unifikon kombin tonë si dhe ruajtjen e raporteve fetare, tolerancës mes myslimanëve dhe katolikëve, që derivon në forcimin e identitetit kombëtar. Pra, ishin shndërruar në tribuna të mendimit fetar dhe kombëtar.[1]

"Shqiptarët që prej kaq shekujsh kanë ruajtur ekzistencën, gjuhën, zakonet dhe karakterin e tyre, janë bindur se duke qenë nën zotnimin e një pushteti tjetër, cilido qoftë, nuk do të vonojnë të humbasin gjithë këto të mira dhe të mbarojnë duke u ndryshuar, prandaj çdo transformim që mund t'i ndryshojë gjuhën, zakonet, traditat dhe kombin e tyre, për ata do të jetë kulm i fatkeqësisë."[2]

1 Rexhep Suma, *Islami dhe Identiteti nga perspektiva e shtypit fetar,* Logos-A, Shkup, 2020, f.41

2 Ndriçim Kulla, *Antologjia e mendimit shqiptar 1870-1945*, Plejad, Tiranë, 2003, f.55.

Qëllimi i daljes së kësaj reviste ishte që të bëhet përpjekje e sinqertë për të mbajtur të ndezur dritën e vërtetë hyjnore. Kjo dritë ka qëllim dy gjëra:1). besimin e gjallë në të Plotfuqishmin si dhe 2). mirëdashjen e vëllazërimin e përgjithshëm në mes njerëzve. E dyta në të vërtetë , është përfundimi i natyrshëm i së parës.[3]

"Mediet transmetojnë eksperienca sekondare dhe në këtë mënyrë zgjerojnë udhën e dijeve, gjykimeve, njohurive dhe eksperiencave në dispozicion të njerëzve. Pjesëmarrja e medieve në komunikimin politik ka pësuar një rritje jashtëzakonisht të madhe në kohën e teknikës moderne të komunikimit. Këtu nuk bëhet fjalë në asnjë mënyrë për një komunikim joefikas, por për artefakte tej e tej ideologjike. Duke mbajtur parasysh rëndësinë politike dhe pasojat e tyre, është e rëndësishme të mësohet interpretimi politik i kulturës mediatike."[4]

Bota sot jeton në epokën e globalizmit ku kemi përsosje të mjeteve të komunikimit. Shkenca e revolucioni teknologjik si dhe digjitalizimi kanë thyer çdo kufi gjeografik. Në këtë hapësirë popujt e "vegjël" nuk mëshirohen e as përkëdhelen më nga popujt e "mëdhenj". Dija po ecën në mënyrë marramendëse. Vetëm me vlera e me prodhim kualitativ kulturor mund të jemi në hap dhe në garë me shoqëritë e zhvilluara. "Parashihet se boshti kryesor i këtij konkurrimi civilizues do të jenë informatat apo fusha e informimit (komunikimit)."[5]

Në editorialin e parë të saj u sqarua kahja dhe zhvillimi i revistës si dhe është vërejtur se revista drejtohej nga dy teolog të rinj të kulturës dhe mendimit islam Sadik Bega, drejtor përgjegjës, Sherif Putra, redaktor i revistës si dhe z. Vexhi Demiraj, profesor në medresenë e përgjithshme dhe ndihmës i përhershëm në përgatitjen e lëndës së revistës.[6] Ky botim ishte me standarde shumë të larta, ishte një pasqyrë e vërtetë e vlerave të inteligjencës myslimane të asaj kohe krizash mendimesh e ideologjish. Penat e shquara të kohës shpalosën mendimet dhe zgjidhjet e tyre për problemet e shoqërisë shqiptare. E këto vlera të shkruara që na lanë trashëgim neve, u takon studiuesve që të hulumtojnë dhe të nxjerrin mësime të dobishme prej tyre, për shumë problematika që e ruajnë akoma aktualitetin e tyre. Qëllimi më i lartë i Islamit s'është tjetër veçse m'e ba njerinë të pasojë atë çka gjuha filozofike e quanë Idealin më të lartë (El methelul 'Aalà), ose atë çka gjuha Ethike e thërret «summum bonum» (e mira e persosun). Njeriu

3 Editoriali, "Kultura islame", shtatuer-tetor, vit i II, nr.13-14, Tiranë, 1940, f.8.

4 Winter, Rainer, *Medienkultur, kritik und demokratie.* Der douglas Kellner Reader.Koln;von halem, 2005, p.12.

5 Tash, Abdulakdir, *Ethekafetu veli'lam ve ma bejnehuma*, Xhide, Arabi Saudite, bot. 3, Obeikan, 1995, f.57.

6 Sadik Bega, "Të ndershëm lexues", *Kultura islame,* viti I, nr.1, shtator 1939, f.2.

tue derdhë gjithë përpjekjen e tij, duhet të konsakrojë jetën e vet për t'ia arrirë idealit më të lartë, kundrejt të cilit, ay orienton të gjitha përpjekjet e tija, tue e arrire ose tue dhënë jetën për të.[7]

Në faqet e kësaj reviste, fjala e shkruar islame, me daljen e disa numrave shndërrohet në tryezën e mendimit islam. Një çështje tjetër që iu kushtua me theks të veçantë është edhe çështja e moralit në doktrinën islame. Morali që predikon Islamizmi është moral i plotësuar dhe shum i lartë, zbatuesi i të cilit tregon një njeri të përsosur, që e meriton me të vërtetë emrin njeri.[8]

Një problem tjetër që hasim në këtë periudhë është dhe përçarja që duan të fusin mes shqiptarëve me besime të ndryshme. Në poezinë "*Jeni të gabuar*" lexojmë: "Ishin gjithë shqiptarë, nuk dallonin Fe, Feja për ta ishte Liri e Atdhe."[9]

Revista "Kultura Islame" rreth vetes ofroi shumë studiues të rinj myslimanë shqiptarë të cilët më pas ndikuan në mënyrë eksplicite në ngritjen dhe formimin e karakterit të saj edukativ, filozofik e moral të lexuesit shqiptarë. Autorët e artikujve në revistën "Kultura Islame" ishin me formim islam ku trajtonin në shkrimet e tyre zanafillën e kulturës islame, shtrirjen dhe përhapjen e tij, të dërguarit e Allahut xh.sh., tema nga rrafshi i moralit dhe etikës publike, rendin dhe respektin familjar, etj. Por, mbi të gjitha, vend të dukshëm në faqet e revistave, zinin shkrimet që kultivonin moralin dhe normat islame, me synim edukimin e njeriut, virtytet e mira, që të edukonin një njeri të vlefshëm për shoqërinë dhe për atdheun.

Në këtë periudhë kohore shumë jo stabile në të cilën ndodhej Ballkani si hapësirë gjeografike për shkak të fillimit të Luftës së Dytë Botërore, revista "Kultura islame" ka përmbushur qëllimin dhe misionin qenësor ndaj lexuesve të saj dhe opinionit publik në Shqipëri dhe trojet e ndryshme shqiptare ku temat dhe artikujt që i trajtonte dhe shtjellonte ishin tema të edukimit, informimit dhe formimit të mendimit të shëndoshë islam karshi situatës sociale që ndodhej shoqëria shqiptare.

Në suaza të kontencës kjo revistë ishte si vijimësi e revistës simotre "Zani Naltë", por me një qasje më të thellë dhe më të gjerë se e para. Gjuha e komunikimit me masën që përdorte kjo revistë thellonte mendimin dhe kulturën islame duke trajtuar dhe shtruar probleme në tryezën e debateve duke tërhequr pas vetes ambient tërheqës për shtresën intelektuale të asaj kohe nga ana e muslimanëve.

7 Po aty, f.7.

8 Sh.S., Morali në fen islame, shtatuer-tetor, vit i II, nr.13-14, Tiranë, 1940, f.31.

9 Kultura Islame, Viti III, Nr.3-4, nëntor-dhjetor 1941, Pseudonimi Kom., "Jeni të gabuar!", f. 86.

Po në këtë segment revista ka arritur të publikoj edhe rolin dhe kontributin e Islamit në shkencë e qytetërim (shkencë dhe fe), kur në perëndim ekzistonin zëra se Islami është një fe penguese e shkencës dhe e qytetërimit. Andaj me sukses revista ka arritur t'i demantoj këto thënie të pa baza që i janë mveshur fesë sonë. Islami në fakt ndihmue qëllimin e shkencës e të qytetnimit mâ tepër se çdo fé tjetër. Historia na dëshmon se përparim modern asht rrjedhimi apo fillimi i lirisë së mendimit e të kërkimit përshkrue nga Kurani për Muslimanët, dhe se nuk âsht prodhim i ndonjë feje tjetër, që urdhëroi e persekutoi pa mëshirë gjithë mendimet e lira dhe arsyetimet e hapta. Evropa i detyrohet Islamit për përparimin e jashtëzakonshëm që tash vonë e ka bamun në shkencë e qytetrim. Arthur Leonard-i me të vërtetë ka paraparë se ,"Islamizmi vërtet ka ba një vepër, që ka lanë një gjurmë në faqet e historisë e cila âsht aqë e pashkitun sa që kurr s'ka për t'u shdukun..." dhe se muslimanët e hershëm lanë një impresion të pashlyeshëm në zhvillimin e kultural të botës s'mundet veçse të pranohet nga çdo kritik i padjallëzueshëm e mendje gjanë i historisë islame.[10]

Faqet e kësaj reviste trajtuan probleme të karakterit empirik dhe teorik si bie fjala nga ana e fushës së jurisprudencës islame si: "*Detyra e grues*" me autori i shkrimit me pseudonimin, *Sashi,* ngrisin shqetësimin për pozitën e rëndë të femrës shqiptare. "Na, nuk mund të pretendojmë që grueja shqiptare sot për sot të jetë në shkallën e nji nâne të mirë, me përjashtim të nji pakice, sepse i mungojnë traditat e kultura e nevojshine, porse âsht edhe aji vepër antinjerëzore e antipatriotike që grueja e jonë të rrijë gjithnji në nji shkallë fare t' ulët. Që t' ja mbërrijmë qëllimit, duhet që vajzat të ndjekin shkollën, pastaj të tjera të frekuentojnë kurse, të ndigjojnë konferenca nga kompetentë, të ndigjojnë predikime nëpër faltore mbi higjienën shtëpijake, mbi rritjen e fëmivet moralisht e fizikisht."[11]

Po në këtë rrafsh ka shkoqitur edhe dy artikuj të kushtuar çështjes së gruas myslimane shqiptare. I pari i titulluar *"Islamizmi dhe gruaja"* studion kushtet e gruas para ardhjes në fuqi të Islamit, duke kërkuar të tregojë mandej të drejtat e saj qenë njohur gjerësisht. Artikulli i dytë është një përgjigje e një letre të hapur drejtuar të rinjve shkodranë nga një vashë myslimane, e cila ankohet për gjendjen e disa grave të Shkodrës që akoma nuk kanë arritur të gëzojnë të gjitha të drejtat e tyre; ajo nxit rininë të mos mbetet indiferent në këto padrejtësi. Autori i artikullit admiron thirrjen e arsyeshme të kësaj vashe, porse ngulmon se që bëhet emancipimi i gruas myslimane, gjendja e së cilës tanimë është e

10 Kultura Islame, Kontributi islam në shkencë e qytetnim, pa autor, viti VI, Nr.1 (61) Shtatuer - 1944, f.8-9.

11 Kultura Islame, Viti I, Nr.1, shtator 1939, Pseudonimi Sashi, "*Detyra e grues*!", f. 33.

përmirësuar së tepërmi, të mos kalohen kufijtë e moralitetit, sepse vetëm në këtë mënyrë Shqipëria e re mund të fitojë kohën e humbur. Ideali i vërtetë i islamit është që njerëzit dhe gratë të përpiqen të gjitha për të ecur vëllezërisht mbi udhën e vërtetë dhe të përparimit[12].

Gruas iu dha edhe haku sa i përket angazhimit të saj në jetën publike të pikëpamjeve kombëtare. "*Gruaja myslimane në pikëpamje kombëtare*", është artikulli i radhës ku autori Sadik Bega vë në pah rolin dhe funksionin e gruas veç tjerash në rritjen dhe edukimin e gjeneratës së re si dhe angazhimet e saj në jetën publike. "Gratë ndihmojnë burrat në punimin e fushavet dhe të tokavet, i shërbejnë miqvet të burrit etj. Ato munden të shesin dhe të blejnë prej burravet dhe anasjelltas. Një grua qe caktua prej Halifës Umer si Kryekujdestare e tregut të Medinës, edhe pse ky rast ishte përjashtim."[13]

Po ashtu revista qartë artikuloi se Islami dhe mendjeshkurtësia janë të pamjaftueshme. "Feja Islame asht që e gjanë sa dhe gjithsija, që përmbledhë në vet-vehte simpatinë e krejt njerëzimit, pa marrë parasysh besimet e ndryshme që ushtrohen prej tjerëve. Fanatizmi dhe kokfortësija në jo të vërtetën i quejmë si mohues të Islamit".[14]

Në këndin etik dhe fetar u prezantuan shkrime filozofiko-morale si për shembull: "*Familja*", '*Islamizimi dhe gruaja*", u botua në numrin 4, 5, me autor Behxhet Shapati, '*Problemi fetar dhe filozofija*", të autorit Vexhi S.Demiraj, e cila u botua në disa vazhdime si në nr 3, "*Islamizimi dhe qytetnimi*", në disa vazhdime në numrin.4,5-6, '*Në botën e mendimeve, filozofija morale*", '*Udhëheqësit e mendimit-Homeri*", në numrin.6-7, 8, nga autori Taha Hussein, etj.

Po ashtu revista në faqet e saj ka botuar edhe artikuj për rrënjosjen e mendimit dhe edukimit fetar tek brezi i ri. Kështu artikulli i radhës me titull "*Gjendja e djeshme dhe e sotshme e elementit shqiptar mysliman në Shqipëri*", në të shkruhet se ky besim duhet t'i ngulet mirë në zemër, në ndërgjegje edhe fëmijvet t'onë e qi edhe këta të bahen të dobishëm në konstruksion dhe në udhëheqëje të popullit, të vetvehtes në të ardhëshmen e tyre. Të naltësohen në pikëpamje shpirti materje."[15]

12 Sadik Bega, "Ç 'shkruan për revistën t'onë shtypi i huaj dhe kombëtar", *Kultura Islame,* viti III, kallnuer - shkurt-mars, 1942, XX, nr. 5-6-7, f.192.

13 Sadik Bega, Gruaja myslimane në pikëpamje kombëtare", *Kultura Islame,* viti III, kallnuer-shkurt-mars, 1942, XX, nr.5-6-7, f.142.

14 *Kultura Islame,* Dy vjetë perpjekje, Editoriali, tetor 1941-XX, viti III, nr.2, f.37.

15 Kultura Islame, Viti I, Nr.6-7 fruer - mars 1940, "Gjendja e djeshme dhe e sotshme e elementit shqiptar mysliman në Shqipëri, Dejtimi - redaksia, f.212.

Më tej në përvjetorin e dytë të daljes së revistës, drejtuesit e revistës e kanë shumë të qartë kahjen dhe orientimin që duhet të kenë të rinjtë tanë duke theksuar se "Ne s'pranojmë dasina dhe s'besojmë nër partina. Sektet janë disa mendime që ndryshojnë vetëm nër detaje, të cilat nuk luejnë asnjë rol në bazat islame. Ndryshmi i mendimeve në mes të muslimanëve janë një burim bekimesh, thotë Profeti i shenjtë. Tue mohue këtë të vërtetë më madhe besojmë se diferencat e sinqerta të menimeve muslimane nuk janë gja tjetër veçse ndihmuese në të mirën e shoqnisë muslimane. Asht qëllimi i ynë t'i armonizojmë ato drejt të mirës e mbarëvajtjes së përgjithshme"[16]

Edhe në atë kohë sikurse edhe sot qarkullonin zëra nga qarqe të ndryshme se feja e paskësh lënë mbrapa kombin tonë dhe si rrjedhojë ne kemi mbetur në margjina të zhvillimit të mendimit dhe artikulimit qytetërimor. "Para islamizmit as filozofia, as ndonjë sistem tjetër, nuk i dha njerëzisë kënaqësi të plotë. Njeriu numërohesh si një trup me epshe të dobta. Disa kujtonin se në natyrën e tij kishte dobësina të pakontrollueshme. Disa të tjerë mendonin se ai asht i dënuem për të gjithë jetën e jetës. Mirë p Islamizmi ka marrë një pikpamje kryekëput të ndryshme kundrejt njeriut dhe zotsive të tij. Njeriu ka lindu i pastër, asht i aftë t'i ruej të gjitha ligjet hyjnore dhe të bajë çdo lloj përparimi; pse asht i pajosun me të gjitha cilësitë e nevojshme-fizike, morale, shpirtnore e mendore- dhe është gjithmonë çelë për t'i përdori ato deri në përplotësim.[17]

Po ashtu, në këtë revistë u botuan edhe studime nga fusha e arteve dhe e historisë, siç ishin "*Fleta artistike*" ku në disa numra janë botuar historia e disa xhamive. Në këtë drejtim në kuadër të studimeve artistike kemi edhe temën "*Kuptimi i artit dhe kufit e tij*"- nga autori Petrit Arveni, i cili flet përkitazi me rrymat e reja artistike që promovohen si Ekspresionizmi dhe Futurizmi si rryma që përfaqësojnë artin e ri, që sipas tij nuk paraqesin në kredon e tyre filozofik tensionet e tyre estetike. Ai shprehet se "Megjithëse në vendin tonë s'kemi tensione dhe rryma të ndryshme artistike, por në kuadër të vetëdijësimit të sqarojmë se këto rryma për lëvizjet artistike të kohës së re dhe me këtë sqaruar edhe në numrat vijues edhe lëvizjet e tjera letrare që vadisin prodhimin e sotshëm dhe shfaq edhe rrezikshmërinë e tyre sepse shpallin lirin absolute t'egosë dhe veprat e tyre nuk na japin atë prekjen e thellë, që na dhuron çlirim i vërtet estetik. Ato tërheqin por, por nuk plotësojnë etjen tonë, na qendrojnë, por vetëm për një çastë duke mos na lënë diçka të thellë në shpirtërat t'onë. "Nga një anë sepse artistët vetë nuk janë marrë me theorinë: ajo qi udhëheq në krijim është diçka e vërbër, por

16 Kultura Islame, Dy vjetë perpjekje, Editoriali, tetor 1941-XX, viti III, nr.2, f.38.

17 Kultura Islame, Viti I, Nr. 6-7 fruer-mars 1940, Pseudonimi P., "Feja e zhvillimit", f.223.

e fortë si instikti, dhe jo mendimi; dhe nga ana tjetër, sepse kritikët estetikë, që përhapin Artin e Ri, kërkuan më tepër ta imponojnë me shpjegimet e tyre estetikë, sesa t'a themelonin dhe t'a shfaqnin me anën e filozofis theorin tij."[18]

Një element tjetër që drejtuesit e kësaj reviste e patën parë parasysh të trajtojnë në këtë kuadër është edhe trajtimi i një sërë temash në kuadër të filozofisë islame, njëherit duke krijuar një rubrikë të veçantë për këtë çështje. Kështu kemi edhe shkrimin me titull "*Hyrje në filosofinë myslimane*" të autorit Sadik Bega. Kur shkruajmë këto rreshta të pakta nuk jemi duke e konsideruar Islamin si një fe ose si një besim fisi. Përkundrazi, Ai është vetë qytetërimi i përsosur; Ai është përfshirës dhe përmbledhës, plot me konceptet qi kanë të bëjnë me jetën mendore, me jetën letrare dhe me jetën morale. Kështu, sipas këtij krahasimi të vërtetë sipas kësaj mase të përpiktë, të gjithë filozofët, myslimanë qofshin ose të tjerë, aqë më tepër, krejt mentonjësit e lirë që bulbëzuanë, u-rritën dhe lulëzuane nën sqetullën e qytetërimit mysliman, jane sazhe (hakime) Islame, nga pikpamja e mentimit, mediumit dhe pasurisë mendore të përbashket. [19]

Në kuadër të mendimit dhe filozofisë islame revista herë pas here ka shtjelluar edhe rubrika nga fleta e tefsirit dhe hadithit, duke mbajtur të informuar masën me përkthimin, komentimin dhe sqarimin e ajeteve që i kanë trajtuar autorët e artikujve. Në fletën e tefsirit gjejmë që ajetet janë shkruar edhe në gjuhën arabe, kurse hadithet si rubrikë janë transkriptuar. Kështu në numrin 7-8 të vitit 1944 më fletën e Tefsirit ka komentuar ajetet 12, 13, 14 të sures *El muminun.*

"Na e krijuëm njerinë nga nji esancë qi e ka origjinën prej balte. Mbasandej e bamë langë të vendosun në nji vend të mprojtun.Pastaj këtë lang të bardhë e bâmë gjak të kuq; edhe këtë gjak e bamë mish, e mrapa këtë mish e këthyëm në eshtëna, e pastaj eshtënat i veshëm me tul, e në fund e trajtuëm në nji krijim tjetër. Pra, sa i naltë asht All-llahu qi âshtë mâ i bukuri i krijuesvet" (XXIII,12,13,14)[20].

Andaj duke bërë shpjegimet e bukura në lidhje me krijimin e njeriut në formën më të përsosur autori sqaron se "Njeriu i arsyeshëm përpara kësaj panorame madhështore dhe të mrekullueëshme nuk mund të bâjë ndryshime veçse të përkulet e të gjunjëzohet me plot devocion e të lavdërojë mençuriën, dituniën dhe pushtetin e Krijuesit të Amshueshëm tue thanë: "fetebareq' Allahu ahsenul-khalikijne- *i naltë âsht All-llahu qi âshtë mâ i bukuri i krijuesvet*[21].

18 Petrit Arveni , "Kuptimi i artit dhe kufit e tij", *Kultura islame,* kallnuer-shkurt-mars, 1942 - XX, nr. 5-6-7, f.156-157.

19 Sadik Bega, Hyrje në filosofinë myslimane, Kultura islame, viti III, kallnuer shkurt - mars 1942, nr.5, f.213.

20 Kultura islame, pa autor, Tefsiri i Kuranit, viti i V.nr.7-8 (55-56), Mars - Prillë 1944, f.173

21 Kultura islame, pa autor, Tefsiri i Kuranit, viti i V. nr.7-8 (55-56), Mars - Prillë 1944,f.179.

Me këto fakte revista dëshiron të mbjellë dhe të heq dyshimet e atyre që janë të luhatshëm ose atyre që nuk e shohin me sy këtë vepër krijimtarie të Allahut xh.sh., ose edhe atyre që nuk duan ta besojnë në ekzistencën e Tij, porse artikulli për këtë soj të krijesave iu shprehet ... *Ata janë porsi shtazët e ndoshta edhe mâ beter...).*

Kurse në kuadër të fletës së hadithit trajton këshillat nga Muhamedi a.s. në lidhje me falënderimin, duke përmendur hadithin "*men lem jeshqurin-nase, lem jeshquril-lahe*." Artikulli sjell në vëmendje një nga tiparet e kulturës islame që ka të bëje me falënderimin duke e theksuar atë se çfarë është dhe si duhet kryhet kundrejt mirsive të ndryshme, dhe se qëllimi i falënderimit qi detyrohemi me krye kundrejtë njerëzisë asht me nderue çdo njeri përmirësit qi na ban dhe prej kësaj ku themelohet në mes të njerëzisë dashtunija qi asht nga mjetet kryesore të harmonisë shoqnore.[22]

Në këtë vazhdë po ashtu shkrime të ndryshme të revistës ofrojnë edhe mendimin e qartë që duhet të ketë besimtari në lidhje me raportin fe dhe komb, aq të diskuteshme në qarqet shqiptare që nga atëherë deri më tash, si dhe këshillon që duhet të shmangemi propagandës së huej e cila synon me na futë në vëllavrasje dhe prej këndej me mundë me shembë eksistencën t'onë si komb. Për me përballë këtë propagandë dhe për me i u shmangë vëllavrasjes âsht me të vërtetë gjâ e vështirë e sidomos sod, por mendojmë se me pak mund ma të madh dhe me pak më shumë vullnet të mirë e sinqeritet, për njerëzit e mirë e të ndershëm të gjitha punët janë të lehta. Duhet pra të shtojmë sa mâ shumë mundun organizimin shtetnor e fetar si dhe atë ekonomikun pa të cilin asgjâ s'kishte me mundë me u krye. Feja na jep mësime të kjartë qi na udhëheqin drejt udhës së shpëtimit. Na jep mësime konkrete mbi ngjalljen dhe mbi vdekjen e kombevet. Simbas saj, solidarësija shoqnore dhe bashkimi prodhojnë gjallnì, ndërsa përçamja dhe dâsija shkaktojnë vdekje. Le të marrim pra masa për me u bashkue e me shpëtue Shqipnin prej rrezikut. Ky âsht zani i Atdheut, kjo âsht Thirrja e Fès. Feja për neve ka nji kuptim të qartë: ajo âsht faktor qi forcon ndërgjegjen kombëtare. Dashunija e Atdheut âsht pasojë e besimit.[23]

Revista po ashtu herë pas here ka qenë edhe zë kritik i qytetërimit modern duke vendosur në spikamë se ky qytetërim është larg qëllimit të tij të vërtetë dhe gjendja e paraqitur në perëndim është duke e brejtur trupin e njerëzimit, dhe se doemos nuk do të shkojë shumë kur ta udhëheq në venitje fizike në një gradë që të mos i ngelë fuqi ose guxim përparime më të larta. Çdo degë e qytetnimit në botën perëndimore ka këthye ose asht tu ndërrue në menën e të e të

22 H.T. Falenderimi, Kultura islame, viti i V. nr.7-8 (55-56), Mars - Prillë 1944, f.182.

23 Editoriali, Destinimi i nji kombi, *Kultura islame,* Nr.9 (57) Majë, 1944, f.241-242.

keqës- e keqe kjo që mbrenda dy tre brezash do të sjellë paralizimin fizik të racës njerëzore, e kështu krejt përparimi do të ndalojë, ku kemi shembull efektin e sëmundjeve e çfrenimeve jo morale veneriane (ngjitëse). Pasojat që vijnë nga kjo sëmundje. Më pas Revista ofron statistika sipas regjistrave se 225.000 fëmijë të paligjshëm lindin çdo vit në Neë York dhe 2.500.000 sëmundje sifilisi mjekohen për çdo vjet dhe 1.500.000 fëmijë të palindun mbyten në barkun e nënave çdo vjet në Amerikë. Në këtë aspekt duke ngritur vetëdijën tek publiku shqiptar musliman dhe më gjerë ajo sqaron se Islami është feja e jetës dhe e parimit e saj praktike kanë prodhue rezultate të kënaqshme. Kurani na është një libër me parime morale të pazbatueshme në merren me ideale të imagjinueshme. Libri islam dhe Mësimet e Muhamedit a.s., kanë një dallim të dukshëm. Ata as nuk reklamojnë mbi moralin në terma të përgjithshme, as që humbin vehten në asgjësime filozofike.

"Islami nuk i jep mësimet e veta në formë të ngatrrueme e të pa kuptueshme por vepron ashtu sikundër ban një kirurg në odën anatomike që ep emnin dhe i gjen vend çdo nyje dhe nerve të keqe, vëzhgon me kujdes ço çështje individuale".[24]

Më tej revista mundohet që nëpërmjet faqeve të saj, mban ndezë apo ta ndezë rishtas shkëndinë e besimit që dikur shkulte malet. Premtimi i tij sjellë me vehte mesazhin e bashkimit të njerëzisë. Islami me njohjen e të drejtave të tjerëve shtron gjysmën e rrugës drejt paqit e vllaznimit. Jemi munduar ti mbajmë parimet islame e të largojmë keqkuptimet që shkaktojnë ndasina. Të bindun urdhrave të besimit t'onë, me ndihmën e Zotit do të jemi me përparim-dashësit e Atdheut, me dashamirësit e popullit, dhe do të mundohemi të mbjellim farën e bashkëpunimit e të dashtunisë drejt dobisë së përgjithshme të Kombit t'onë. [25]

Po ashtu në kuadër të rubrikave që ka pasur kjo revistë është edhe ngritja e përgjegjësisë që duhet të kenë predikuesit e fesë islame-hatibët e vaizët. Me titullin "*Disa predikime*", predikuesi Sulejman Kadiu, ku ofron një model për predikuesit që kishte të bënte për temën e drejtësisë.

PËRFUNDIM

Revista "Kultura islame" ka lëvizur drejt qëllimit të saj pa bërë zhurmë duke bërë shërbim jo çfarë e dëshiron koha por çfarë ka nevojë shoqëria, për të shënuar dhe trajtuar përparim shpirtëror e kulturor në mesin e shoqërisë shqiptare. Ajo mbetet një revistë shpirtërore e kulturore, edukative e filozofike e dorës së parë,

24 Kultura islame, Qytenim'i çalë, pa autor, viti III, gusht 1942, Rexhep shaban, n.12, f.351.

25 Sh., Kultura islame, tre vjet mund, viti IV, shtatuer - tetor 1942, Rexhep shaban, nr.1-2, f.351.

duke mbjellë dhe dhënë shoqërisë shqiptare ushqimin shpirtëror e mendor të shëndetshëm. Ajo me guximin e saj ka trajtuar tema e problematika të guximshme të problemeve të kohës nën prizmin shoqëror, fetar e kombëtar.

Kontributi i publicistikës islame ka qenë i dukshëm dhe i dobishëm sepse në të u pasqyruan materiale origjinale jo vetëm të përkthyera por të hartuara nga të rinj dhe intelektualë shqiptarë me tematikë të gjërë dhe shumëdimensionale. Shtypi islam në Shqipëri paraqet vlera të edukimit fetar e atij patriotik kombëtar të bazuara mbi filozofinë islame. Artikujt e shumtë e publikuar në revistën "Kultura Islame" kanë shërbyer për të rritur më tej vlerën që ka kultura islame në trojet shqiptare, qëndrimin dhe përkrahjen që Islami i bën historisë, shoqërisë dhe në veçanti gruas dhe rolit të saj si përçuese e vlerave më të mira shoqërore në edukimin dhe rritjen e brezit të ri.

Kjo revistë ka lënë gjurmë të pashlyeshme në ngritjen e formimin e mendimit dhe qytetërimit islam ndër shqiptarë, dhe çdo numër i saj meriton të studiohet e analizohet veç e veç. Për të arritur këto objektiva ajo ka afruar rreth vetes penda të kohës të dëshmuar të gjeneratave të reja dhe vjetra, që dhanë mesazhe shprese për studime dhe artikuj serioz shkencor dhe që ka reflektuar me besimin që ka treguar lexuesi ndaj saj.

LITERATURA

Abdulakdir Tash, Ethekafetu veli'lam ve ma bejnehuma, Xhide, Arabi Saudite, bot. 3, Obeikan, 1995, f. 57.

Editoriali, "Kultura islame", shtatuer - tetor, vit i II, nr.13-14, Tiranë, 1940.

Editoriali, Destinimi i nji kombi, Kultura islame, Nr.9 (57) Majë,1944.

H.T. Falenderimi, Kultura islame, viti i V. nr. 7-8 (55-56), Mars - Prillë 1944.

Kultura Islame, Dy vjetë perpjekje, Editoriali, tetor 1941- XX, viti III, nr.2.

Kultura Islame, Dy vjetë perpjekje, Editoriali, tetor 1941 - XX, viti III, nr.2.

Kultura Islame, Kontributi islam në shkencë e qytetnim, pa autor, viti VI, Nr.1 (61) Shtatuer -1944.

Kultura islame, pa autor, Tefsiri i Kuranit, viti i V. nr.7-8 (55-56), Mars - Prillë 1944.

Kultura islame, pa autor, Tefsiri i Kuranit, viti i V. nr.7-8 (55-56), Mars - Prillë 1944.

Kultura islame, Qytenim'i çalë, pa autor, viti III, gusht 1942, Rexhep Shaban, n.12.

Kultura Islame, Viti I, Nr.1, shtator 1939, Pseudonimi Sashi, "*Detyra e grues*!".

Kultura Islame, Viti I, Nr.6-7 fruer - mars 1940, "Gjendja e djeshme dhe e sotshme e elementit shqiptar mysliman në Shqipëri, Drejtimi - redaksia.

Kultura Islame, Viti I, Nr.6-7 fruer - mars 1940, Pseudonimi P., "Feja e zhvillimit".

Kultura Islame, Viti III, Nr.3-4, nëntor - dhjetor 1941, Pseudonimi Kom., "Jeni të gabuar!".

Ndriçim Kulla, *Antologjia e mendimit shqiptar 1870-1945*, Plejad, Tiranë, 2003.

Petrit Arveni , "Kuptimi i artit dhe kufit e tij", Kultura islame, kallnuer - shkurt-mars, 1942 - XX, nr.5-6-7.

Rainer, Winter. *Medienkultur, kritik und demokratie.* Der douglas Kellner Reader. Koln;von halem, 2005.

Rexhep Suma, Islami dhe Identiteti nga perspektiva e shtypit fetar, Logos-A, Shkup, 2020.

Sadik Bega, "Të ndershëm lexues", Kultura islame, viti I, nr.1, shtator 1939.

Sadik Bega, Ç 'shkruan për revistën t'onë shtypi i huaj dhe kombëtar", Kultura Islame, viti III, kallnuer - shkurt-mars, 1942, XX, nr.5-6-7.

Sadik Bega, Gruaja myslimane në pikëpamje kombëtare", Kultura Islame, viti III, kallnuer - shkurt-mars, 1942, XX, nr.5-6-7.

Sadik Bega, Hyrje në filosofinë myslimane, Kultura islame, viti III, kallnuer - shkurt-mars 1942, nr.5.

Sh., Kultura islame, tre vjet mund, viti IV, shtatuer - tetor 1942, Rexhep Shaban, nr.1-2.

Sh.S., Morali në fen islame, shtatuer - tetor, vit i II, nr.13-14, Tiranë, 1940.